

**Data 25.03.2023
Ora 15:08**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

PJESËMARRJA :

KQZ:

• Komisioni Rregullator:

- | | | |
|------------|-----------|--------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, M. Koja |
| Parti | Politike: | PDIU, PL |
| OJQ: | | KRIIK |

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, datë 25 mars. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, zyrtarë të tjerë të administratës dhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore. Zoti, Sekretar i Përgjithshëm, më lejoni të prezantohen përfaqësuesit e partive politike, me çfarë cilësie ndodhen sot në sallë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

Z. F. Guri: Fjoralb Guri i Partisë së Lirisë.

Znj. I. Nano: Në rregull. Në këtë seancë jeni përfaqësues zëvendësues?

Z. F. Guri: Përfaqësues i përhershëm në KQZ.

Znj. I. Nano: Zotëria?

Z. K. Xhemali: Klardi Xhemali përfaqësues i subjektit zgjedhor PDIU.

Znj. I. Nano: Në rregull. Faleminderit! Në mbledhjen e sotme, siç është njoftuar, kemi një projektvendim për shqyrtim, është projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore””. Propozimi ka ardhur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kështu që do të ftoja zoti Merkaj për ta prezantuar, por përpara se të prezantonte projektaktin, nëse kolegët kanë diçka për rendin e ditës, pra ndonjë çështje për t’u diskutuar jashtë rendit të ditës? Nuk ka. Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Neni 98, pika 5, i Kodit Zgjedhor ka parashikuar kompetencën e KQZ-së për organizimin e hedhjes së shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen, menjëherë sapo të ketë përfunduar regjistrimi i listës shumëmemërore në KQZ apo, sipas rastit, në KZAZ. Rregullat për hedhjen e shortit përcaktohen me akt normativ të KQZ-së. Në zbatim të dispozitave të mësipërme, kemi përgatitur edhe projektaktin e mësipërm. Pas miratimit të vendimit nr. 8, datë 23.2.2023 të Komisionit Rregullator dhe në vijim të fushatës së edukimit që ka marrë KQZ-ja, janë vërejtur paqartësi nga ana e zgjedhësve. Qëllimi i këtyre

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

ndryshimeve lidhet me shmangien e pavlefshmërisë së fletëve të votimit. Ky projektvendim përcakton mekanizmin e hedhjes së shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për këshillat e bashkisë. Shorti dhe parashorti, siç është parashikuar edhe në vendimin nr.8, do të kryhet në 4 raunde. Në raundin e parë do të përfshihen në short subjektet zgjedhore, të cilat kanë regjistruar lista shumemërore kandidatësh në të gjitha zonat zgjedhore. Në raundin e dytë do të përfshihen në short subjektet zgjedhore, të cilat kanë regjistruar listat shumemërorë në më shumë se 31 zona zgjedhore. Në raundin e tretë përfshihen në short subjektet zgjedhore, të cilat kanë regjistruar listat shumemërorë deri në 30 zona zgjedhore. Në raundin e katërt përfshihen në short kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë. Në rast se për një zonë zgjedhore regjistrohen dy ose më shumë kandidatë, shorti do të hidhet ndërmjet tyre. Renditja e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit bëhet në raundin e katërt. Në renditjen përfundimtare kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë vendosen pas renditjes së partive politike ose koalicioneve. Projektvendimi parashikon se numrat e përfshirë në short janë në rend rritës dhe të barabartë me numrin e subjekteve që do të marrin pjesë në short. Numrat që shënohen në shiritat e letrës të përfshirë në raundin pararendës nuk përfshihen në raundin vijues. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim, si dhe relacionin përkatës. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj! Kolegë, fillojmë shqyrtimin dhe diskutimin në parim të projektvendimit. Me sa u relatua, nuk ndryshon ajo pjesë e vendimit që lidhet me shortin për kryetarët e bashkisë, por ndryshon ajo pjesë e vendimit që lidhet me shortin për të përcaktuar renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën për këshillin e bashkisë. Duke qenë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka filluar fushatën e edukimit të zgjedhësve prej kohës, siç u relatua nga Sekretari i Përgjithshëm, ka paqartësi dhe për të shmangur një numër të caktuar fletësh të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

pavlefshme, është parashikuar ky ndryshim. Keni diçka, kolegë, në parim për projektvendimin? Përfaqësuesit e subjekteve? Jo. Përfaqësuesit e shoqërisë civile? Në rregull. Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator, vendosi: 1. Në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator bëhen ndryshimet si më poshtë: a) Në nenin 2, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si vijon: Renditja e subjekteve zgjedhore dhe e kandidatëve për kryetar të njësisve të qeverisjes vendore në fletët e votimit bëhet nga numri më i vogël te numri më i madh, sipas për zgjedhjes rastësore (short) të numrave natyrorë. 2. Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për këshillin e bashkisë bëhet në katër raunde si vijon: a) Në raundin e parë përfshihen në short subjektet zgjedhore, të cilat kanë regjistruar lista shumëmemërore kandidatësh në të gjitha zonat zgjedhore. b) Në raundin e dytë përfshihen në short subjektet zgjedhore, të cilat kanë regjistruar listat shumëmemërore në më shumë se 31 zona zgjedhore. c) Në raundin e tretë përfshihen në short subjektet zgjedhore, të cilat kanë regjistruar listat shumëmemërore deri në 30 zona zgjedhore. d) Në raundin e katërt përfshihen në short kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë. Në rast se për një zonë zgjedhore regjistrohen dy ose më shumë kandidatë, shorti do të hidhet ndërmjet tyre. Renditja e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit bëhet në raundin e katërt. Në renditjen përfundimtare kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë vendosen pas renditjes së partive politike dhe koalicioneve. b) Në nenin 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: Nëndarja i. Në

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

fund të fjalisë së parë të pikës 1 të nenit 4 shtohen fjalët “për secilin raund”. Nëndarja ii. Shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si vijon: “Parashorti për secilin raund zhvillohet si më poshtë:”. iii. Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet si vijon: “Shorti për raundin e parë zhvillohet si më poshtë:”. iv. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje: “c) E njëjta procedurë e përcaktuar në shkronjën “b” ndiqet për çdo raund. Numrat e përfshirë në short janë në rend rritës dhe të barabartë me numrin e subjekteve që marrin pjesë në secilin raund. Numrat që shënohen në shiritat e letrës të përfshirë në raundin pararendës nuk përfshihen në raundin vijues.”. Kjo është pika 1 e vendimit, që, në fakt, përfshin të gjitha ndryshimet. Pikat 2 dhe 3 lidhen me hyrjen në fuqi dhe me të drejtën e ankimit. Kështu që fillojmë, nëse për pjesët e veçanta të pikës 1, së pari, pyes subjektet zgjedhore, përfaqësuesit, kanë diçka e më tej anëtarët e komisionit.

Z. F. Guri: Po, e nderuar kryetare, mund të diskutoj. Te pika 2, shkronja “a” thuhet që në raundin e parë përfshihen në short subjektet zgjedhore, të cilat kanë regjistruar lista shumemërore kandidatësh në të gjitha zonat zgjedhore. Supozojmë që janë 10 subjekte zgjedhore, që kanë regjistruar të plotë listën e kandidatëve në 61 bashkitë. Në këtë raund do të shortohen numrat nga 1 në 10, këtë ka nënkuptuar kjo, ose nëse ka nënkuptuar këtë, mos është pak e dyshimtë dhe mos duhet sqaruar dhe përcaktuar qartë?

Znj. I. Nano: Administrata mundet dikush të përgjigjet, sepse kjo lidhet, me sa e lexoj aktin, edhe me pikën 1, me renditjen e subjekteve nga numri më i vogël te numri më i madh duke pasur parasysh numrat natyrorë. Zonja Koja.

Znj. M. Koja: Për t’iu përgjigjur pyetjes, po, pikërisht nënkupton atë që ka kuptuar edhe zotëria. Në raundin e parë përfshihen në short subjektet zgjedhore,

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

të cilat kanë regjistruar listën në të 61 bashkitë dhe në short përfshihen aq numra sa janë subjekte që paraqesin listën.

Z. F. Guri: Ideja është që mos duhet të përcaktohet më qartë që për raundin e parë do të përdoren numrat nga 1 deri aq subjekte sa janë.

Znj. M. Koja: Ajo është thënë.

Z. F. Guri: Dakord, mos duhet sqaruar më qartë në këtë pikë.

Znj. M. Koja: Nëse keni ndonjë propozim ju për këtë, ndoshta.

Z. F. Guri: Ose mund të jetë propozim i tillë, për shembull, që numrat rendorë të fillojnë nga 1 deri tek aq subjekte zgjedhore sa janë të regjistruara sipas raundit të parë, që kap subjektet zgjedhore që janë regjistruar në të gjitha bashkitë.

Znj. M. Koja: Është e thënë te procedura e shortit kjo. Po të lexojmë nenet e mëposhtme, nëse do të shkojmë te neni 4 i vendimit në fuqi, në shkronjën “b”, në nënndarjen e parë përcaktohet që përgatitet shirita letre, ku në secilin prej tyre shënohet një numër duke filluar nga numri 1 deri te numri i barabartë me numrin e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short.

Znj. I. Nano: Pra, tek akti që kemi miratuar një muaj më parë është e përcaktuar.

Z. F. Guri: Dakord.

Znj. I. Nano: Kolegë, ju keni diçka për pikën 1? Po, zoti Çela.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

Z. A. Çela: Faleminderit, kryetare! Kam një propozim për sa i përket fjalës “raund”, që përmendet në të gjithë aktin, të zëvendësohet me fjalën “fazë”.

Znj. I. Nano: Para se ta kaloj në votim këtë, do të pyesja edhe një herë administratën çfarë ka pasur parasysh dhe a konsiderohet nga ana e tyre se fjala “fazë” nënkupton fazë kohore, se raundi edhe mund të na ngatërrojë.

Z. M. Koja: U përzgjedh fjala “raund” për të nënkuptuar që janë katër faza të ndara nga njëra-tjetra dhe pasuese të njëra-tjetrës. Kështu që propozimi mund të vlejë, në fakt, në rastin konkret.

Znj. I. Nano: Personalisht edhe unë kam diçka në këtë pikë, nuk e di nëse kolegët e tjerë kanë, po të kalojmë me votimin e propozimit të parë të zotit Çela? Zoti Çela, ju propozoni që fjala “raund” në të gjithë aktin të zëvendësohet me fjalën “fazë”.

Kush është dakord me propozimin e zotit Çela?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka.

Me 5 vota pro miratohet.

Po, zoti Çaka.

Z. D. Çaka: Duke pasur parasysh që miratuam edhe përcaktimin e fazave që do të përfshihen në short, unë do të kisha një propozim: duke qenë se në fazën e parë janë të përfshira ato subjekte zgjedhore që kanë paraqitur kandidatë në listat shumëmemërore në çdo zonë zgjedhore, ndërkohë në draft citohet “në fazën e dytë përfshihen në short subjektet zgjedhore që kanë regjistruar listat shumëmemërore në më shumë se 31 zona zgjedhore”. Në shkronjën “c” thuhet “deri në 30 zona

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

zgjedhore”. Duke pasur parasysh një ndërthurje të të dyja pikave, në qoftë se do t’i qëndrojmë propozimit “në më shumë se 31 zona zgjedhore”, i bie që të jenë 32 e sipër. Kështu që automatikisht numri 31 i zonës zgjedhore do të ngelej i zbuluar. Por, duke pasur parasysh që numri me 61 zona zgjedhore është i përfshirë në fazën e parë, do të propozoja që shkronja “b” të ndryshohej me këtë formulim: “Në fazën e dytë përfshihen në short subjektet zgjedhore, të cilat kanë regjistruar listat shumemërore nga 31 deri në 60 zona zgjedhore”. Pra, të jetë e përcaktuar ky numër i këtyre zonave zgjedhore dhe në këtë mënyrë i kemi të përcaktuara në mënyrë eksplicite numrat përkatës dhe nuk lëmë vend as për ekuivoqe e as për gjë.

Znj. I. Nano: Kolegë, lidhur me këtë interpretim më tepër me karakter matematikor e logjik, por që u përkthye në propozim, kení diçka? Kalojmë në votim.

Kush është dakord me propozimin e zotit Çaka për riformulimin e shkronjës “b”?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Unë kisha diçka për shkronjën “d”. Thjesht vlerësoj që kemi një përsëritje, pra fjalía e fundit: “Renditja e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit bëhet në fazën e katërt.”. Në fakt, është thënë që në fjalinë e parë: “Në fazën e katërt përfshihen në short kandidatët e propozuar nga zgjedhësit...”, kështu që propozoj të hiqet si fjali.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Ka diçka tjetër. Po zoti Çaka.

Z. D. Çaka: Faleminderit, kryetare! Doja të bëja edhe një propozim te shkronja “b”, pika 4. Pra, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje: “ E njëjta procedurë e përcaktuar në shkronjën “b” ndiqet për çdo fazë. Numrat e përfshirë në short janë me rend rritës dhe të barabartë me numrin e subjekteve që marrin pjesë në secilën fazë. Numrat që shënohen në shiritat e letrës të përfshirë në fazën pararendëse nuk përfshihen në fazën vijuese.”. Atëherë, duke qenë se kenë përcaktuar në një pikë më lart që kenë katër faza, vlerësoj që këtu ku thuhet “përfshirë në fazën pararendëse” nuk duhet të jetë vetëm në fazën pararendëse, por duhet t’i përfshijë të gjitha fazat pararendëse. Pra, të shtohet dhe të bëhet “Numrat që shënohen në shiritat e letrës të përfshirë në fazën/fazat pararendëse nuk përfshihen në fazën vijuese.”. Pra, që të përfshijë të gjitha fazat, sepse mund të jemi edhe në fazën e tretë të shortit dhe automatikisht duhet të përfshijë edhe të dytën, edhe të parën. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Kolegë, e votojmë edhe këtë propozim të zotit Çaka.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

Më duhet ta votoj në tërësi pikën 1 të projektvendimit, sepse deri tani kemi votuar katër ndryshime për të.

Kush është dakord me pikën 1 të projektvendimit me të gjitha ndryshimet e miratuara?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka.

Me 5 vota pro miratohet.

“Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 3. “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Do ta votojmë në tërësi projektvendimin, pasi e kemi votuar në parim dhe çdo pikë të tij. Edhe një herë ju lutem, kolegë, dakordësinë tuaj.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.03.2023*

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Meqenëse nuk kemi pikë tjetër në rendin e ditës për të shqyrtuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 13

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

